



KPP Nr. 12/2018

Thirrje për propozim për zhvillimin e 15 (pesëmbëdhjetë) standardeve të profesionit

EYE është duke e mbështetur sektorin e Arsimit dhe Aftësisimit Profesional me ofrimin e programeve shkollore/trajnuese që i përshtaten kërkesave të tregut të punës. Për të arritur këtë, gjatë zhvillimit të programeve shkollore/trajnuese duhet të krijohet një komunikim/konsultim i theksuar midis ekspertëve profesional nga sfera e punës dhe ofruesve të arsimit/trajnitimit. Kjo do të sigurojë një përshtatje më të mirë të kërkesës me ofertën. Një prej mënyrave për realizimin e konsultimit është zhvillimi i standardeve të profesionit. Si rrjedhojë, EYE i bënë thirrje konsulentëve apo kompanive konsulente të interesuara që të aplikojnë për zhvillimin e 15 standardeve të profesionit. Të interesuarit mund të aplikojë për një grup të veçuar apo të trija grupet e standardeve të profesionit të paraqitura në vijim:

Grupi 1:

- 7131 Punëtorët për ngjyrosje dhe punëtorët e ngjashëm
- 7122 Shtuesit e dyshemesë dhe punëtorët për vendosjen e pllakave
- 7111 Ndërtuesit e shtëpive
- 7123 Suvatuesit
- 7119 Punëtorët e kornizave të ndërtimit

Grupi 2:

- 3432 Dizajnerët dhe dekoratorët e interierit
- 7318 Punëtorët e zejës me tekstil, lëkurë dhe materiale të ngjashme
- 7534 Prodhuesit e sfungjerëve dhe të ngjashëm
- 3212 Teknikët e laboratorit mjekësor dhe patologjik
- 3142 Teknikët e hortikulturës

Grupi 3:

- 7127 Mekanikët për kondicioner dhe pajisje ftohëse
- 3131 Punëtorët e impiantit për gjenerimin e energjisë
- 3511 Teknikët e operimit me teknologjinë e informimit dhe komunikimit
- 4322 Nëpunësit për prodhim
- 3522 Teknikët e inxhinierisë së telekomunikimit

Ofertuesit e interesuar duhet t'i përmbushin këto kritere:

1. Përvojë të dëshmuar në sektorin e AAP;
2. Së paku 3 vite përvojë në zhvillimin e standardeve të profesionit në sektorin e AAP;

Dokumentacioni që duhet te dorëzohet:

1. Propozimi teknik
2. Personeli i propozuar
3. Oferta financiare

Ky është një njoftim publik për dhënie të kontratës dhe përzgjedhja do të bëhet duke u bazuar në kriteret e lartpërmendura. Ju lutemi shkarkojeni formularin e TeR nga ueb-faqja e EYE (www.eye-kosovo.org) dhe dërgojeni dokumentacionin jo më vonë se **19.11.2016 në ora 16:00**.

Personi kontaktues: znj. Elheme Xheladini

HELVETAS Swiss Intercooperation - Kosovo

Rr: Nazim Gafurri 33, P.O. Box 210000, Prishtinë

EYE ka të drejtë të mos ofrojë mbështetje, nëse vlerësimi dëshmon se projekti nuk i përmbushë kriteret dhe nuk kontribuon në arritjen e rezultateve të projektit.